



Qendra për Arsim e Kosovës
Kosova Education Center

KEC

SHKOLLA “MILENIUMI I TRETË”

Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur më 29 mars 2005 aprovoi këtë

RREGULLORE PËR REGJIMIN SHTËPIAK

NXËNËSIT E SHKOLLËS “MILENIUMI I TRETË” KANË TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË E TYRE

MBAJE NË MEND:

Ti ke të drejtë-të trajtohesh me respekt dhe mirësi.

Kjo do të thotë se askush nuk do të përqeshë apo lëndon ndjenjat tua.

Ti ke të drejtë-të jesh personalitet në klasë.

Kjo do të thotë se askush nuk do të të trajtojë në mënyrë të padrejtë vetëm se je : vajzë apo djalë, i trashë apo i dobët ,i shpejtë apo i ngadalshëm.

Ti ke të drejtë-të jesh i sigurt në klasë.

Kjo do të thotë se askush nuk do të të godas, shtyej,ngacmoj, fyej apo lëndoj në asnjë mënyrë.

Ti ke të drejtë-të mësohesh për vetveten në klasë.

Kjo do të thotë se do të jesh i lirë të shprehësh ndjenjat dhe mendimet tua pa frikë se do të të ndërprejnë apo dënojnë për një gjë të tillë.

Ti ke të drejtë-të çmohesh dhe respektohesh së bashku me vlerat dhe dobësitë tua.

MBAJE NË MEND ,TI JE I OBLIGUAR:

- *Secili nxënës ka për detyrë që të ndihmojë dhe të bashkëpunojë me të tjerët.*

- *Secili nxënës ka për detyrë që t'i respektojë të tjerët.*

Kjo do të thotë se në shkollën tonë nuk do të lejohet që ndaj ndonjërit të përdoret dhuna dhe agresiviteti fizik, duke përfshirë edhe lojërat "luftarake".

- *Për sjellje jo të mira çdoherë duhet të jipet përgjegjësi.*

Në raste të tilla vjen deri te biseda me prindin/kujdestarin, drejtorin, raportimi, dënimi për një kohë të caktuar ose detyrimi për kryerjen e ndonjë shërbimi (varësisht nga pesha e gabimit)

Në raste më serioze, nxënësi mund të largohet nga shkolla për një kohë të caktuar e pastaj të kthehet së bashku me prindin/kujdestarin që të shqyrtohen hapat e ardhshëm.

Në rast se nuk ka përmirësime, nxënësi largohet përgjithmonë nga shkolla.

- *Shkolla jonë synon t'i përkrah nxënësit me sjellje të mira, me vetë-disiplinë dhe nxënësit me vullnet për mësim.*

Kur nxënësi sillet mirë dhe tregon rezultate në mësim, kjo do të vlerësohet nga mësimdhënësi/ja apo nga kujdestari/ja e klasës.

Nëse nxënësi tregon rezultate të mira në mësim apo aktivitete tjera, ai/ajo do të shpërblehet.

- *Nëse ndiheni të ofenduar për shkak të asaj që ju kanë thënë apo bërë të tjerët, keni të drejtë të kërkonit që diçka e tillë të ndërpritet.*

Së pari ju duhet t'i drejtoheni kujdestarit të klasës, cilitdo mësimdhënësi, drejtorit të shkollës apo ndokujt në familje të cilët do të jenë në gjendje që të të ndihmojnë.

- *Në shkollë nxënësi lejohet të sjellë vetëm gjëra të nevojshme për procesin arsimor.*

Nxënësi është përgjegjës për çdo gjë që e sjell në shkollë, nëse humbet apo vidhet, duhet përsëri të kompensohet.

Nëse në shkollë nxënësi sjell telefon mobil, duhet të kujdeset mirë për të.

Telefoni duhet të fiket brenda në shkollë. Nëse mësimdhënësi e vëren telefonin në klasë, ai do ta konfiskojë atë.

Rreptësisht ndalohet të sillen në shkollë cigare, shkrepsa, mjete të forta apo çfarëdo tjetër që do të mund të lëndojë këdo.

Edhe pse ne mundohemi shumë t'i mësojmë njerëzit që ta respektojnë

pronën e të tjerëve, megjithatë ka njerëz që i vjedhin gjërat e pa

mbikqyra. Prandaj, nëse nxënësi do të kërkojë që gjërat e tij të vlefshme të

mos vidhen, atëherë këshillohet që t'i mbikqyrë apo të mos i sjellë në shkollë

fare.

PREMTIMET E NXËNËSVE:

UNË DO TA RESPEKTOJ VETVETEN

Unë e kuptoj se shkolla ime më ofron një fillim të mrekullueshëm në jetën time, prandaj do të mundohem të përfitoj sa më shumë nga kjo, e kjo arrihet nëse:

- unë dëgjoj gjatë orës së mësimi dhe bashkëpunoj me të tjerët
- unë do të jem i/e saktë në shkollë dhe do t'i kryej obligimet e mia me kohë
- unë nuk do të lejojë që të tjerët të ma tërheqin vëmendjen më shumë se mësimi.
- mbi të gjitha unë do t'i caktoj synimet e mia dhe do ta detyroj vetveten t'i përmbush ato, si dhe do të punoj me arsimtarët e mi dhe me familjen time që të sigurohem se jam duke e shfrytëzuar maksimumin e mundësive të mia.

UNË DO T'I RESPEKTOJ TË TJERËT

Unë jam i/e vetëdijshëm se edhe të tjerët meritojnë t'u jipet e njëjta shansë sikurse edhe mua, prandaj unë nuk do të bëj asgjë që do t'i pengonte ata.

- unë do të sigurohem se ata i kanë të qarta mësimet dhe detyrat, pa i bezdisur ata.
- unë e kuptoj se njerëzit janë të ndryshëm e kjo e bën mjedisin tonë më tërheqës, prandaj unë do të jem tolerant dhe i intersuar në ndryshimet që të tjerët sjellin.
- unë nuk do të jem i dhunshëm apo agresiv.
- unë e di se t'i përqeshësh apo t'i ofendosh të tjerët nuk është aspak e këndshme, prandaj unë kurrë nuk do të bëj një gjë të tillë.
- unë do ta respektoj gjithë personelin shkollor si dhe do të jem mirënjohës për mundin e tyre të dhënë për edukimin tim.

UNË DO TA RESPEKTOJ SHKOLLËN TIME

Unë e di se shumë kohë, mund dhe para janë dhënë për t'u ndërtuar kjo shkollë për mua, duke më ofruar atë që unë e meritoj, prandaj unë jam krenar për këtë.

- unë do të kontribuoj që shkolla ime të duket sikur në ditën kur për herë të parë është hapur.
- unë e kuptoj se mjetet dhe pajisjet që ndodhen këtu janë në shërbim të të gjithëve, përfshirë edhe mua, prandaj do të kujdesem që të mos dëmtoj asgjë, si dhe nuk do të shfrytëzoj apo marr asgjë që nuk më nevojitet.
- unë nuk do të bëj asgjë që do ta rrezikojë këtë ndërtesë të mrekullueshme.

UNË DO TË JEM PËRFAQËSUES I MIRË I SHKOLLËS SIME

Unë e kam të qartë se jam përfaqësues i rëndësishëm i shkollës sime, prandaj do të sillim me respekt dhe pjekuri kur ndodhem jashtë shkollës.

- unë nuk do të ngatërrohem me askë dhe nuk do të përdor fjalë të ndyra në rrugë,
- nëse të tjerët nuk sillen mirë me mua unë do t'i injoroj ata.

PREMTIMET E PRINDËRVE

- Unë premtoj se do të marr përgjegjësinë që ta përkrah djalin/vajzën tim/e të jetë i/e suksesshme në shkollë.

Unë personalisht ju siguroj se djali/vajza ime do të arrijë me kohë në shkollë, i veshur si duhet (uniforma) dhe me të gjitha librat dhe pajisjet e nevojshme. Unë po ashtu ju siguroj se fëmija im do të vijë i përgatitur fizikisht, pasi ka fjetur mjaft, është ushqyer mirë dhe ka pushuar mjaft që të mos ketë problem në përqëndrim gjatë orarit mësimor. Nëse fëmija im është i sëmurë dhe nuk mund të vijë në shkollë, unë do të telefonoj para orës 08 që të njoftoj në shkollë për mungesën e fëmijës tim, e pastaj do ta sjell një shkresë ku do të sqaroj arsyen e mungesës. Nëse fëmija im do të mungojë nga shkolla për të shkuar në vizitë mjekësore ose ndonjë arsye tjetër, unë do të kërkoj paraprakisht nga personeli i shkollës që fëmija im të lirohet në ditët e caktuara.

Unë do të sigurohem se janë kryer pagesat e nevojshme për fëmijën tim (për ushqim , transport etj.).

- Unë premtoj se do të jem aktiv dhe i interesuar për arsimimin e fëmijës tim. Unë do t'i lexoj raportet dhe letrat e dërguara nga shkolla për mua, si dhe do të bëj të pamundurën që njëri nga prindërit/kujdestarët e fëmijës do të jenë prezent në mbledhjet e prindërve. Nëse në shtëpinë tonë ndodh diç që do të ndikojë në mbarëvajtjen e mësimi të fëmijës tim, unë do ta njoftoj kujdestarin e klasës. Përveç kësaj unë do ta inkurajoj, ndihmoj, stimuloj dhe shtyj fëmijën tim deri te kufijtë e mundshëm të arritshmërisë.

- Unë premtoj se do ta respektoj shkollën dhe gjithë personelin shkollor. Nëse ndonjë masë disiplinore merret ndaj fëmijës tim, unë do të respektoj përvojën dhe mirëkuptimin e personelit arsimor. Unë do ta mësoj fëmijën tim se si duhet të sillet në shkollë dhe se duhet të i përmbahet premtimeve të veta.

- Unë premtoj se do të jem i kyçur sa më shumë në aktivitetet e shkollës. Përkundër angazhimeve të mia unë do të jem i gatshëm të ndihmoj, duke pasë parasysh se personeli shkollor do t'i orientojë drejt aftësitë e mia, duke ofruar maksimumin e kohës së lirë, në mënyrë që prezenca ime të ndikojë te fëmija im që të ndiej se ndodhet në një ambient të afërt dhe të ngrohtë.

Në të njejtën kohë unë pres:

- Që shkolla t'i ofrojë fëmijës tim shkollim të klasit të parë.
- Ndërhyrje të afërt nga ana ime në arsimimin dhe e dukimin e fëmijës tim
- Që fëmija im të respektohet.

Bazuar në nenin 4 pika 5 e Statutit të shkollës fillore dhe të mesme të ulët “Mileniumi i Tretë” Këshilli Drejtues dhe Drejtori i shkollës në rast të prishjes së rendit dhe disipline do të zbatojnë:

MASA DISIPLINORE

Në këtë rregullore do të trajtohen dhe sanksionohen:

1. Mënyra e sjelljes së nxënësve në klasë gjatë orëve të mësimit të rregullt;
2. Mënyra e sjelljes së nxënësve gjatë orëve të studimit, mësimit plotësues, mësimit shtues dhe aktiviteteve të lira;
3. Mënyra e sjelljes së nxënësve në korridore, kabinete, nyje sanitare dhe në oborrin e shkollës;
4. Mënyra e sjelljes së nxënësve në kombibus;
5. Mënyra e sjelljes së nxënësve gjatë mësimit në natyrë, gjatë vizitave të institucioneve të ndryshme, pikniqeve etj.
6. Mënyrën e sjelljes së nxënësve gjatë marrjes së ushqimit, mëngjesit dhe drekës

Neni 1

Përgjegjësitë e nxënësve gjatë orëve të mësimit

- 1.1. Nxënësi është i obliguar të respektojë rendin në klasë, të dëgjojë me vëmendje kur mësimitdhënësi flet;
 - 1.2 Të mos pengojë shokun ose shoqen gjatë orës mësimore duke i ndërhyrë verbalisht ose duke e ngacmuar fizikisht;
 - 1.3 Të mos ndërrojë grupin kur atij ose asaj i teket pa kurrëfarë shkasi dhe pa lejen e mësimitdhënësit;
 - 1.4 Të mos e dëmtojë inventarin në klasë dhe ta mirëmbajë atë;
 - 1.5 Të mos i dëmtojë muret e klasës duke i varur punimet e ndryshme,
- Për nxënësit që nuk respektojnë pikat **1,2,3,4,5** të nenit **1** pason masa disiplinore **vërejtje me shkrim** dhe kompensim i dëmit material.

Neni 2

Përgjegjësitë e nxënësve gjatë orës së studimit, mësimit plotësues, shtues dhe aktiviteteve të lira:

- 2.1 Nxënësit nuk i lejohet të pengojë shokun ose shoqen gjatë orës së studimit, mësimit shtues, plotësues ose aktiviteteve të lira.
- 2.2 Çdo nxënës është i obliguar që gjatë studimit të punojë me prioritete, së pari t'i kryejë detyrat nga lëndët boshtore, të realizojë detyrat e projektit në bashkëpunim me grupin, pastaj të inkuadrohet në aktivite të lira.
- 2.3 Aktivitetet fizike që zhvillohen jashtë orës së edukatës fizike mund të realizohen vetëm në prani të mësimitdhënësit përkatës.

Neni 3

Përgjegjësitë e nxënësve gjatë pushimit të gjatë, punës në kabinete, punës në natyrë dhe gjatë vizitave të ndryshme

- 3.1 Nxënësit nuk i lejohet që të vrapojë nëpër korridore, të qëndrojë pa nevojë në WC, të keqpërdorë aparatit për tharjen e duarve, letrën higjienike apo mjetet tjera;
 - 3.2 Nxënësit nuk i lejohet keqpërdorimi, jashtë detyrave të planifikuara me projekt internetit, aparatit fotokopjues apo shtypësit;
 - 3.3 Nxënësit nuk i lejohet dëmtimi i pemëve, rrethojës, ulëseve, shportave higjienike etj në oborrin e shkollës;
- Për nxënësit që nuk respektojnë pikat **1,2,3** të nenit **3** pason masa disiplinore **vërejtje me shkrim** dhe kompensim i dëmit material.

Neni 4

4.1 Nxënësi është i obliguar të dalë në kohë të caktuar para banesës/shtëpisë sipas marrëveshjes me përgjegjësën e sigurimit të udhëtimit. Nëse për ndonjë arsye nxënësi nuk është në gjendje ta bëjë këtë, prindi ose kujdestari i nxënësit është i obliguar ta njoftojë përgjegjësën e udhëtimit;

4.2 Nxënësi gjatë udhëtimit duhet të qëndrojë i ulur në ulëse dhe nuk guxon të ofendojë vozitësin e kombibuesit;

4.3 Vozitësi i kombibusit nuk guxon të konsumojë duhan gjatë kohës së vozitjes së fëmijëve dhe të përgojë ose ofendojë nxënësin apo njerëz të tjerë në shkollë; Për nxënësin që nuk respekton pikën **1** dhe **2** të nenit **4** shkolla nuk merr kurrëfarë përgjegjësie për sigurimin e udhëtimit të tij, prandaj prindi ose kujdestari e zgjidhin vetë këtë problem.

Nëse vozitësi i kombibusit nuk respekton pikën **3** të nenit **4** do të **largohet** dhe në vend të tij do të angazhohet vozitësi tjetër.

Neni 5

5.1. Nxënësi është i obliguar t'i respektojë të gjitha rregullat e komunikuarat gjatë vizitave jashtë shkollës, gjatë organizimit të programeve kulturo-artistike dhe gjatë pikniqeve të ndryshme.

Për nxënësin i cili nuk respekton rendin e përcaktuar më parë sipas pikës **1** të nenit **5** do të largohet nga vizita/pikniku dhe do t'i komunikohet vërejtja me shkrim.

Neni 6

6.1 Nxënësi është i obliguar të respektojë orarin e përcaktuar shkollor gjatë marrjes së ushqimit. Pas shujtës së mengjesit dhe drekës, çdo nxënës është i obliguar të rregullojë tavolinën e vetë dhe t'i largojë mbeturinat. Kujdes të posaçëm duhet t'i kushtohet konsumimit të lëngjeve, qumështit dhe produkteve të tij. Nuk lejohet derdhja e tyre në dysheme ose në banka.

Për mos respektimin e pikës **1** të nenit **6** nxënësi ndëshkohet me vërejtje me shkrim.

MASAT TJERA DISIPLINORE

Procedurën disiplinore ndaj nxënësit e inicon kujdestari i klasës i cili ia përcjell propozimet e veta drejtorit të shkollës.

Neni 7

7.1 Me fillimin e procedurës disiplinore do të mbahet një bisedë në mes të drejtorit dhe nxënësit ndaj të cilit është inicuar procedura disiplinore. Në këtë bisedë mund të jenë të pranishëm edhe anëtarë tjerë të personelit mësimor të ftuar nga drejtori, si dhe prindi ose kujdestari i nxënësit ndaj të cilit është inicuar procedura disiplinore.

7.2 Pas përfundimit të bisedës dhe shqyrtimit të gjithanshëm të fakteve, drejtori merr vendim për lirim të nxënësit nga përgjegjësia ose për shqiptimin e masës disiplinore të përcaktuar me nenin **4.11** të Statutit të shkollës.

7.3 Drejtori mund ta largojë përkohësisht nxënësin nga shkolla deri në përfundim të procedurës disiplinore ose ta sistemojë në paralele tjetër.

7.4 Masat disiplinore janë:

- Vërejtja me shkrim
- Vërejtja publike
- Largimi i përkohshëm nga shkolla deri në 5 ditë pune
- Largimi nga shkolla

7.5 Masa e largimit nga shkolla do të aplikohet vetëm nëse janë shterrë të gjitha mundësitë tjera për zgjidhjen e problemit dhe hyn në fuqi me vërtetimin e saj nga ana e Këshillit drejtues.